

Programi EmPOWER për Gratë Politikane në nivel lokal

Thirrje për aplikime

A jeni grua që aktualisht mban pozitë drejtuese në nivel lokal apo politikane aspiruese e etur për të avancuar karrierën, formësuar politikat publike dhe për të nxitur ndryshime domethënëse në komunitetin tuaj?

Nëse po, programi EmPOWER për Gratë Politikane në nivel lokal është krijuar për ju!

Duke u bazuar në suksesin e edicioneve të mëparshme, Misioni i OSBE-së në Kosovë është krenar që të nis edicionin e katërt të *EmPOWER Programi i Grave Politikane në nivel lokal* (EmPOWER), që synon fuqizimin e grave për të luajtur rol më të madh në zgjedhjet e ardhshme lokale të vitit 2025. Programi ofron punëtori gjithëpërfshirëse për ndërtimin e kapaciteteve, mentorim dhe mundësi për të mësuar nga homologët, duke i përgatitur gratë që të tregojnë, udhëheqin, marrin pjesë në proceset vendimmarrëse dhe të bëhen faktorë me ndikim të ndryshimit në nivel lokal.

Pasqyrë e programit

Edicioni i katërt i EmPOWER është program njëvjeçar, me prani fizike dhe offline, që mëton zhvillimin dhe rritjen e aftësive drejtuese politike të grave në pozitat vendimmarrëse dhe të atyre që aspirojnë të hyjnë në politikë, veçanërisht në përgatitje për zgjedhjet lokale të vitit 2025. I rrënjësor në parimet e barazisë, përfshirjes, transparencës dhe llogaridhënies, ky program përqendrohet në forcimin e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit kuptimplotë të grave në proceset politike lokale.

Qëllimet e EmPOWER:

- **Të përmirësojë aftësitë e udhëheqjes politike** të grave.
- **Të ndërtojë vetëbesim** për t'u mundësuar grave që të ndërmarrin veprime të guximshme politike dhe të pozicionohen si krijuese efektive të ndryshimeve.
- **Të nxit pjesëmarrjen aktive politike** përmes nismave që inkurajojnë udhëheqjen veç e veç dhe bashkërisht.
- **Të zgjerojë mundësitë e rrjetëzimit** mes grave politikane.
- **Të përgatit pjesëmarrësit për sukses zgjedhor**, duke ofruar vegla pune për fushatën politike, informimin e votuesve dhe angazhimin e komunitetit, me fokus të veçantë në zgjedhjet lokale të vitit 2025.
- Të pajis gratë me shkathtësi për të **manovruar në mjedis politik të dominuar nga burrat** dhe për të **luftuar dhunën ndaj grave** në hapësira publike.

Struktura dhe temat

Në programin *EmPOWER* do të marrin pjesë deri në 30 gra politikane, udhëheqëse aktuale dhe kandidat aspiruese. Programi do të përmbajë:

- Një **seancë trajnimi njëditor** për të paraqitur konceptet kryesore (prill 2025).
- Dy **punëtori trajnimi dyditore** të projektuara për të thelluar mësimin dhe praktikën (maj dhe qershor të vitit 2025).

- **Uebinare, diskutime tematike në panel, dhe ngjarje të rrjetëzimit shtesë gjatë gjithë vitit (nga prilli deri në nëntor të vitit 2025).**

Temat kryesore që do të mbulohen janë:

- **Zhvillimi dhe konsolidimi i udhëheqjes politike dhe ndikimit.**
- **Fjalimi dhe debati publik për gratë në politikë.**
- **Strategjitë e komunikimi politik dhe informimit të votuesve.**
- **Planifikimi dhe realizimi i fushatave efektive elektorale.**
- **Rrjetëzimi, mbledhja e fondeve nga publiku (crowdfunding) dhe sigurimi i burimeve.**
- **Trajtimi i dhunës ndaj grave në politikë.**
- **Siguria digjitale për kandidatet femra.**
- **Kuptimi i sistemeve zgjedhore dhe kornizave ligjore për gratë në politikë.**
- **Ndërtimi dhe ruajtja e aleancave strategjike politike.**

Seancat do të udhëhiqen nga një ekspert ndërkombëtar, me përkthim simultan në gjuhët angleze, shqipe dhe serbe. Folës të shquar nga politika, shoqëria civile dhe academia do të ndajnë njohuritë dhe përvojat e tyre gjatë gjithë programit.

Kriteret e pranimit

Ftojme gratë nga kuvendet komunale, grupet lokale të grave, me fokus të veçantë **gratë nga komunitete joshumicë, si dhe gratë nga grupet e cënueshme**, duke përfshirë edhe ato që aspirojnë pozita politike, që të aplikojnë. Kandidatët e kualifikuar duhet të demonstrojnë përkushtim të fuqishëm ndaj barazisë gjinore dhe përfaqësimit politik të grave.

Për t'u kualifikuar, secila aplikante duhet:

- Të jenë grua e cila aktualisht është në pozitë drejtuese në nivel lokal ose kandidate aspiruese.
- Të tregojë përkushtim për të avancuar karrierën e saj politike dhe për të kontribuar në politikat dhe vendimmarrjen publike.
- Të angazhohet për pjesëmarrje të plotë në të gjitha aktivitetet e programit, duke përfshirë punëtoritë, kampet e trajnimit dhe seancat e mentorimit.

Procesi i përzgjedhjes do t'i japë përparësi grave nga komunitetet joshumicë dhe grupet e cënueshme për të siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës, me theks të fortë në diversitetin gjeografik dhe përfaqësimin e komunitetit.

Procesi i përzgjedhjes

Pas shqyrtimit të të gjitha aplikacioneve, komisioni përzgjedhës i përbërë nga përfaqësues të Misionit të OSBE-së në Kosovë do të përzgjedhë 30 kandidate që i plotësojnë kriteret e pranimit në program.

Aranzhimet e programit

Të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me programin, përfshirë transportin, akomodimin, ushqimin, pijet freskuese dhe materialet e kursit, do të mbulohen plotësisht nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Si të aplikoni?

Për të aplikuar, ju lutemi dorëzoni dokumentet e mëposhtme në Empower@osce.org:

- **CV** (përfshirë hollësitë e kontaktit)
- **Letër motivuese** (një faqe)

Afati i aplikimit është **16 mars 2025, ora 23:59**. Aplikimet mund të dorëzohen në gjuhën angleze, shqipe ose serbe.

Ne e mirëpresim aplikimin dhe punën me ju për të forcuar udhëheqjen e grave në politikën lokale përpara zgjedhjeve të vitit 2025!